



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



100 Vjet Pavarësi

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Nr. 633 Prot.

Tiranë, më 18/10/2012

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Nr. 1541 Prot.

Tiranë, më 18/10/2012

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET:

AUTORITETIT TË KONKURRENCËS DHE AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

- Duke parë nevojën për bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe mirëkuptimin dypalësh, në mënyrë që të lehtësohet kryerja e funksioneve të tyre përkatëse në mbështetje të legjislacionit në fuqi;
- Synimin për krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e lidhjeve dypalëshe;
- Mbështetjen në parimet e barazisë dhe përfitimit të përbashkët;
- Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm të politikës së konkurrencës në promovimin e zhvillimit efektiv në një ekonomi tregu;

Lidhet ky Memorandum Mirëkuptimi midis palëve:

Autoritetit të Konkurrencës (në vijim **Autoriteti**) me seli Rruga "Sami Frashëri, Nr. 4, Kati IV", Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari Znj. Lindita MILO (LATI);

si dhe

Autoritetit të Aviacionit Civil (në vijim **AAC**), me seli Rruga: Muhamed Gjollesha ; Parku i Delegacionit, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i saj Z. Ervin MINAROLLI;

Të cilet këtu e më poshtë do të njihen si "palët".

DUKE QENË SE:

Autoriteti është organ publik, i pavarur në kryerjen e detyrave të veta dhe përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kontrollon rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, nxjerr akte detyruese për zbatimin e tyre dhe bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për sigurimin e rregullave të vendosura për konkurrencën;

dhe,

AAC është institucion publik, i pavarur, i cili ka mision kryesor mbikëqyrjen me qëllim garantimin e standardeve në ofrimin e shërbimeve në fushën e transportit ajror, të sigurta dhe të parrezikshme. AAC synon krijimin e një sistemi transporti ajror të përshtatshëm me zhvillimet e reja dhe me kërkesat ekonomike të Shqipërisë;

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1 **Qëllimi dhe Objekti**

- 1.1 Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi i palëve për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe të ndershme në përputhje me Ligjin nr 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kulturës së konkurrencës.
- 1.2 Objekti është përcaktimi i rregullave procedurale për realizimin e bashkëpunimit midis palëve për realizimin e qëllimit më sipër, si dhe përcaktimi i fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit për vendosjen dhe garantimin e zbatimit të rregullave për një konkurrencë të lirë dhe efektive në operatorët e sektorit të aviacionit civil.

Neni 2 **Baza Ligjore**

Për lidhjen dhe zbatimin e këtij memorandumi, palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore si më poshtë:

- Ligji Nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), (neni 24, 69 dhe neni 70, pika 3); (në këtë marrëveshje referuar si "Ligji"); dhe
- Ligji Nr. 10040, datë 22.12.2008 "Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji Nr 10233, datë 11.2.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", i ndryshuar.

Neni 3 **Parime të Përgjithshme**

Duke qenë se:

- 3.1. Aviacioni civil synon të garantojë zhvillimin e një transporti ajror që do të përmbushë pjesën më të madhe të kërkesave të komunitetit të aviacionit

- ne Shqipëri si edhe te publikut ne përgjithësi; duke e arritur këtë ne një mënyrë e cila te jete efikase, te ofroje siguri, dhe te jete ekonomikisht e dobishme dhe gjithmonë ne përputhje me zhvillimet e reja te aviacionit;
- 3.2. Interesi publik për stabilitetin dhe sigurinë e sektorit te aviacionit civil mbetet i veçantë edhe për shkak të problematikës dhe rëndësisë jetike qe ka ky sektor.
- 3.3. **Autoriteti** dhe **AAC** kanë përgjegjësinë e mbrojtjes së bizneseve dhe konsumatorëve nga veprimet abuzive në sektorin e aviacionit civil.
- 3.4. AAC është autoriteti rregullator dhe autoriteti i vetëm përgjegjës për licencimin e operatoreve qe veprojnë ne sektorin e aviacionit civil.

Neni 4 **Të drejtat dhe detyrimet**

- 4.1. Institucionalizohet në mënyrë të rregulluar, sipas këtij memorandumit dhe akteve të tjera të nevojshme të pranuar nga palët, bashkëpunimi reciprok në përmbushje të detyrimeve ligjore të ndërsjella në fushën e forcimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në sektorin e aviacionit civil.
- 4.2. **Autoriteti** bashkëpunon për rritjen e konkurrencës së lirë dhe efektive duke dhënë mendimet e tij në rastet e kufizimit, ndërhyrjes dhe deformimit të tregut në këtë sektor.
- 4.3. Palët do të bashkëpunojnë për të bërë studime tregu lidhur me gjendjen e konkurrencës dhe me propozimet për rregullimet ligjore e nënligjore për të përmirësuar situatën aktuale në këtë treg lidhur me treguesit e konkurrencës.
- 4.4. Të gjitha projektet e akteve nënligjore të nxjerra prej palëve, që lidhen me operatorët e këtij sektori dhe që referojnë kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin e shërbimeve, imponimin e praktikave të njëjta me çmime dhe kushte të shitjes etj, do të konsultohen paraprakisht me Autoritetin, me qëllim funksionimin normal të sektorit në përputhje me objektivat e detyrimeve ligjore dhe për të garantuar standardet për një konkurrencë të lirë dhe efektive.
- 4.5. **Autoriteti** dhe **AAC** do të publikojnë dhe/ose shkëmbejnë zyrtarisht të dhëna dhe informacione, në masën që lejojnë dhe detyrojnë ligjet ku bazohet ky memorandum, duke respektuar në rast nevojë karakterin e tyre konfidencial, dhe që kanë të bëjnë me problemet e konkurrencës në sektorin aviacionit civil.
- 4.6. Kjo marrëveshje synon sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit midis dy institucioneve. Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi do të bëhet vetëm nëpërmjet mënyrave të lejuara nga dispozitat në fuqi që rregullojnë kuadrin ligjor të funksionimit të dy institucioneve;
- 4.7. Kjo marrëveshje shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore. Kjo marrëveshje nuk ndryshon ndonjë ligj ose akt nënligjor në fuqi. Gjithashtu nuk ndikon ndonjë marrëveshje tjetër që **Autoriteti** ose **AAC** kanë me institucione të tjera. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje, nuk mund të cenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej institucioneve, që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të të cilit këto institucione janë krijuar dhe funksionojnë.

4.8. Autoriteti bashkëpunon për rritjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg nëpërmjet ndalimit të praktikave anti-konkurrese dhe kontrollit të përqendrimeve. Institucionet njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit ose bashkëpunim, në bashkërendim me ligjet respektive ose kërkesat rregullatorë. Kërkesa mund të mos plotësohet në këto situata:

- a) kur informacioni i kërkuar është në kundërshtim me ndonjë ligj;
- b) kur informacioni i kërkuar komprometon proceset hetimore apo gjyqësore;
- c) kur kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë Marrëveshje.

4.9. Secila prej palëve të përcaktojë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit që përcakton ky memorandum.

Neni 5 FORMAT E BASHKËPUNIMIT

5.1. Kërkesat për informacion ose bashkëpunim bëhen me shkrim, në gjuhën shqipe dhe të plota. Ato duhet t'i drejtohen personit të kontaktit të Institucionit marrës të kërkesës ;

1. Kërkesat për informacion ose bashkëpunim duhet të sigurojnë:

- a) një përshkrim të përgjithshëm lidhur me subjektin për të cilin kërkohet informacion;
- b) qëllimin për të cilin i kërkohet informacioni;
- c) kohën e dëshiruar për marrjen e përgjigjes;
- d) angazhimin e Institucionit kërkues dhe të personelit të tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të dhënave personale sipas ligjeve të fuqi.

5.2. Institucioni marrës i kërkesës pasi analizon çdo kërkesë për informacion, i siguron Institucionit kërkues informacionin që ai zotëron. Në rast se kërkesa nuk mund të pranohet, Institucioni marrës i kërkesës duhet të japë përgjigjen me shkrim Institucionit kërkues, në lidhje me shkaqet që e pengojnë dhënien e informacionit. Është detyra e Institucionit marrës të kërkesës që të përcaktojë shkallën e konfidencialitetit të informacionit që do të japë.

Neni 6 PËRDORIMI I INFORMACIONIT DHE KONFIDENCIALITETI

6.1. Institucioni kërkues do ta përdorë informacionin e marrë vetëm me qëllim të ushtrimit të funksioneve të saj ligjore për qëllimet e përcaktuara në kërkesë ose për qëllime brenda kuadrit të përgjithshëm të përdorimit të shprehura në kërkesë.

6.2. Institucioni kërkues i informacionit angazhohet të marrë masat e duhura për mbajtjen e konfidencialitetit si dhe të informojë punonjësit e saj për natyrën

konfidenciale të informacionit dhe të përmbajtjes së kësaj marrëveshje. Institucionet nënshkruese duhet të ruajnë informacionin që merr nga institucioni tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi si dhe nga pala që ofron informacionin.

- 6.3. Veprimet nga institucionet nënshkruese sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në mënyrë të veçantë shkëmbimet e informacioneve, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Dispozita përfundimtare

7.1. Asnjë ndryshim nuk mund t'i bëhet këtij Memorandumi në mënyrë të njëanshme, përveçse me shkrim, si dhe pasi palët të kenë rënë dakord paraprakisht midis tyre dhe të kenë autorizuar ndryshimin nëpërmjet nënshkrimit nga titullarët e palëve.

7.2. Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga **Autoriteti** dhe **AAC** dhe është i vlefshëm, deri sa palët të kërkojnë me shkrim shfuqizimin ose shuarjen e tij.

7.3. Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme e këtij Memorandumi mund të bëhet në çdo kohë, nga **Autoriteti** dhe **AAC**, por duke lajmëruar me shkrim 30 ditë më parë palën tjetër.

7.4. Memorandumi hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë pjesë e tij nuk është në tejkallim ose kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore mbi të cilat palët mbështesin ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre.

7.5. Palët zotohen të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë Memorandumin për sa parashikohet në të. Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, secila nga palët mund të tërhiqet dhe të ndërpresë në mënyrë të njëanshme Memorandumin, sipas përcaktimit në pikën 7.3.

7.6. Me qëllim lehtësimin dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm për zbatimin e këtij memorandumi. Palët bien dakord që të caktojnë personat dhe mënyrën e kontaktit midis tyre, si më poshtë:

Për **Autoritetin**: Znj.Daniela Laze
Tel. 04 2234 504
Fax. 04 2234 497
E-mail: dmehmeti@caa.gov.al
 competition@caa.gov.al

Për AAC:

Z.

Tel:

Fax:

E- mail:

Memorandumi i Mirëkuptimit, mbahet në gjuhën shqipe, në katër(4) kopje, nga dy për secilën palë, nënshkruhet dhe hyn në fuqi sot më dt. ____ .10. 2012 .

Për

Autoritetin e Konkurrencës

KRYETAR


Lindita MILO (LATI)


Për

Autoritetin e Aviacionit Civil

DREJTOR


Ervin MINAROLLI




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Projekt

AUTORITETI I KONKURRENCËS

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Nr. _____ Prot.

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____/____/2011

Tiranë më ____/____/2011

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET:

AUTORITETIT TË KONKURRENCËS DHE AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

- Duke parë nevojën për bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe mirëkuptimin dypalësh, në mënyrë që të lehtësohet kryerja e funksioneve të tyre përkatëse në mbështetje të legjislacionit në fuqi;
- Synimin për krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e lidhjeve dypalëshe;
- Mbështetjen në parimet e barazisë dhe përfitimit të përbashkët;
- Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm të politikës së konkurrencës në promovimin e zhvillimit efektiv në një ekonomi tregu;

Lidhet ky Memorandum Mirëkuptimi midis palëve:

Autoritetit të Konkurrencës (në vijim **Autoriteti**) me seli Rruga "Sami Frashëri, Nr. 4, Kati IV", Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari Znj. Lindita MILO (LATI);

si dhe

Autoritetit të Aviacionit Civil (në vijim **AAC**), me seli Rruga: Muhamed Gjollështa ; Parku i Delegacionit, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i saj Z. Ervin MINAROLLI;

Të cilet këtu e më poshtë do të njihen si "palët".

DUKE QENË SE:

Autoriteti është organ publik, i pavarur në kryerjen e detyrave të veta dhe përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kontrollon rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, nxjerr akte detyruese për zbatimin e tyre dhe bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për sigurimin e rregullave të vendosura për konkurrencën;

Dhe,

AAC është institucion publik, i pavarur, i cili ka mision kryesor mbikëqyrjen me qëllim garantimin e standardeve në ofrimin e shërbimeve në fushën e transportit ajror, të sigurta dhe të parrezikshme. AAC synon krijimin e një sistemi transporti ajror të përshtatshëm me zhvillimet e reja dhe me kërkesat ekonomike të Shqipërisë;

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi dhe Objekti

- 1.1** Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi i palëve për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe të ndershme në përputhje me Ligjin nr 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kulturës së konkurrencës.
- 1.2** Objekti është përcaktimi i rregullave procedurale për realizimin e bashkëpunimit midis palëve për realizimin e qëllimit më sipër, si dhe përcaktimi i fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit për vendosjen dhe garantimin e zbatimit të rregullave për një konkurrencë të lirë dhe efektive në operatorët e sektorit të aviacionit civil.

Neni 2 Baza Ligjore

Për lidhjen dhe zbatimin e këtij memorandumi, palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore si më poshtë:

- Ligji Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), (neni 24, 69 dhe neni 70, pika 3); (në këtë marrëveshje referuar si “Ligji”); dhe
- Ligji Nr. 10040, datë 22.12.2008 “Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr 10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar.

Neni 3

Parime të Përgjithshme

Duke qenë se:

- 3.1. Aviacioni civil synon të garantojë zhvillimin e një transporti ajror që do të përmbushë pjesën më të madhe të kërkesave të komunitetit të aviacionit në Shqipëri si edhe të publikut në përgjithësi; duke e arritur këtë në një mënyrë e cila të jetë efikase, të ofrojë siguri, dhe të jetë ekonomikisht e dobishme dhe gjithmonë në përputhje me zhvillimet e reja të aviacionit;
- 3.2. Interesi publik për stabilitetin dhe sigurinë e sektorit të aviacionit civil mbetet i veçantë edhe për shkak të problematikës dhe rëndësisë jetike që ka ky sektor.
- 3.3. **Autoriteti** dhe **AAC** kanë përgjegjësinë e mbrojtjes së bizneseve dhe konsumatorëve nga veprimet abuzive në sektorin e aviacionit civil.
- 3.4. AAC është autoriteti rregullator dhe autoriteti i vetëm përgjegjës për licencimin e operatorëve që veprojnë në sektorin e aviacionit civil.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet

- 4.1. Institucionalizohet në mënyrë të rregulluar, sipas këtij memorandumi dhe akteve të tjera të nevojshme të pranuar nga palët, bashkëpunimi reciprok në përmbushje të detyrimeve ligjore të ndërsjella në fushën e forcimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në sektorin e aviacionit civil.
- 4.2. **Autoriteti** bashkëpunon për rritjen e konkurrencës së lirë dhe efektive duke dhënë mendimet e tij në rastet e kufizimit, ndërhyrjes dhe deformimit të tregut në këtë sektor.
- 4.3. Palët do të bashkëpunojnë për të bërë studime tregu lidhur me gjendjen e konkurrencës dhe me propozimet për rregullimet ligjore e nënligjore për të përmirësuar situatën aktuale në këtë treg lidhur me treguesit e konkurrencës.
- 4.4. Të gjitha projektet e akteve nënligjore të nxjerra prej palëve, që lidhen me operatorët e këtij sektori dhe që referojnë kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin e shërbimeve, imponimin e praktikave të njëjta me çmime dhe kushte të shitjes etj, do të konsultohen paraprakisht me Autoritetin, me qëllim funksionimin normal të sektorit në përputhje me objektivat e detyrimeve ligjore dhe për të garantuar standardet për një konkurrencë të lirë dhe efektive.
- 4.5. **Autoriteti** dhe **AAC** do të publikojnë dhe/ose shkëmbejnë zyrtarisht të dhëna dhe informacione, në masën që lejojnë dhe detyrojnë ligjet ku bazohet ky memorandum, duke respektuar në rast nevojë karakterin e tyre konfidencial, dhe që kanë të bëjnë me problemet e konkurrencës në sektorin e aviacionit civil.
- 4.6. Kjo marrëveshje synon sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit midis dy institucioneve. Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi do të bëhet

vetëm nëpërmjet mënyrave të lejuara nga dispozitat në fuqi që rregullojnë kuadrin ligjor të funksionimit të dy institucioneve;

- 4.7. Kjo marrëveshje shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore. Kjo marrëveshje nuk ndryshon ndonjë ligj ose akt nënligjor në fuqi. Gjithashtu nuk ndikon ndonjë marrëveshje tjetër që **Autoriteti** ose **AAC** kanë me institucione të tjera. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje, nuk mund të cenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej institucioneve, që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të të cilit këto institucione janë krijuar dhe funksionojnë.
- 4.8. **Autoriteti** bashkëpunon për rritjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg nëpërmjet ndalimit të praktikave anti-konkurrese dhe kontrollit të përqendrimeve. Institucionet njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit ose bashkëpunim, në bashkërendim me ligjet respektive ose kërkesat rregullatorë. Kërkesa mund të mos plotësohet në këto situata:
- a) kur informacioni i kërkuar është në kundërshtim me ndonjë ligj;
 - b) kur informacioni i kërkuar komprometon proceset hetimore apo gjyqësore;
 - c) kur kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë Marrëveshje.
- 4.9. Secila prej palëve të përcaktojë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit që përcakton ky memorandum.

Neni 5 FORMAT E BASHKËPUNIMIT

- 5.1. Kërkesat për informacion ose bashkëpunim bëhen me shkrim, në gjuhën shqipe dhe të plota. Ato duhet t'i drejtohen personit të kontaktit të Institucionit marrës të kërkesës ;
1. Kërkesat për informacion ose bashkëpunim duhet të sigurojnë:
- a) një përshkrim të përgjithshëm lidhur me subjektin për të cilin kërkohet informacion;
 - b) qëllimin për të cilin i kërkohet informacioni;
 - c) kohën e dëshiruar për marrjen e përgjigjes;
 - d) angazhimin e Institucionit kërkues dhe të personelit të tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të dhënave personale sipas ligjeve të fuqi.
- 5.2. Institucioni marrës i kërkesës pasi analizon çdo kërkesë për informacion, i siguron Institucionit kërkues informacionin që ai zotëron. Në rast se kërkesa nuk mund të pranohet, Institucioni marrës i kërkesës duhet të japë përgjigjen me shkrim Institucionit kërkues, në lidhje me shkaqet që e pengojnë dhënien e informacionit. Është detyra e Institucionit marrës të kërkesës që të përcaktojë shkallën e konfidencialitetit të informacionit që do të japë.

Neni 6

PËRDORIMI I INFORMACIONIT DHE KONFIDENCIALITETI

- 6.1. Institucioni kërkues do ta përdorë informacionin e marrë vetëm me qëllim të ushtrimit të funksioneve të saj ligjore për qëllimet e përcaktuara në kërkesë ose për qëllime brenda kuadrit të përgjithshëm të përdorimit të shprehura në kërkesë.
- 6.2. Institucioni kërkues i informacionit angazhohet të marrë masat e duhura për mbajtjen e konfidencialitetit si dhe të informojë punonjësit e saj për natyrën konfidenciale të informacionit dhe të përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje. Institucionet nënshkruese duhet të ruajnë informacionin që merr nga institucioni tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi si dhe nga pala që ofron informacionin.
- 6.3. Veprimet nga institucionet nënshkruese sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në mënyrë të veçantë shkëmbimet e informacioneve, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Dispozita përfundimtare

- 7.1. Asnjë ndryshim nuk mund t'i bëhet këtij Memorandumi në mënyrë të njëanshme, përveçse me shkrim, si dhe pasi palët të kenë rënë dakord paraprakisht midis tyre dhe të kenë autorizuar ndryshimin nëpërmjet nënshkrimit nga titullarët e palëve.
- 7.2. Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga **Autoriteti** dhe **AAC** dhe është i vlefshëm, deri sa palët të kërkojnë me shkrim shfuqizimin ose shuarjen e tij.
- 7.3. Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme e këtij Memorandumi mund të bëhet në çdo kohë, nga **Autoriteti** dhe **AAC**, por duke lajmëruar me shkrim 30 ditë më parë palën tjetër.
- 7.4. Memorandumi hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë pjesë e tij nuk është në tejkallim ose kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore mbi të cilat palët mbështesin ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave e tyre.
- 7.5. Palët zotohen të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë Memorandumin për sa parashikohet në të. Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, secila nga palët mund të tërhiqet dhe të ndërpresë në mënyrë të njëanshme Memorandumin, sipas përcaktimit në pikën 7.3.
- 7.6. Me qëllim lehtësimin dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm për zbatimin e këtij memorandumi. Palët bien dakord që të caktojnë personat dhe mënyrën e kontaktit midis tyre, si më poshtë:

Për **Autoritetin:** Znj.Daniela Laze
Tel. 04 2234 504
Fax. 04 2234 497
E-mail: dmehmeti@caa.gov.al
 competition@caa.gov.al

Për **AAC:** Z.
Tel:
Fax:
E- mail:

Memorandumi i Mirëkuptimit, mbahet në gjuhën shqipe, ne katër(4) kopje, nga dy për secilën palë, nënshkruhet dhe hyn në fuqi sot më dt._____ 2012 .

Për

Autoritetin e Konkurrencës

Për

Autoritetin e Aviacionit Civil

K R Y E T A R

D R E J T O R

Lindita MILO (LATI)

Ervin MINAROLLI